

Data 17.02.2020

FTESE PËR SHPREHJE INTERESI PËR PËRGATITJEN E PYETËSORIT PËR AKSESIN NË FINANCA TË SME-VE DHE SHPËRNDARJEN E TIJ TEK BIZNESET SME TË QARKUT FIER

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPHZ), në kuadër të projektit ‘3C4SME Work Plan of the Context Analysis’, per realizimin e nje studimi ne Bashkinë Fier, **hap thirrjen për shërbime për formatimin e pyetësorit dhe shpërndarjen e tij bizneseve të qarkut Fier** si më poshtë.

Informacion i përgjithshëm rreth QSHPHZ

QSHPHZ-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për çështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues dhe zhvillimin.

Organizata duke qënë implemetuese e projektit: “3C4SME Work Plan of the Context Analysis”, i cili zbatohet nga Qendra Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin ne Bashkine Fier, hap thirrjen për shërbime:

- Kompani/OJF per sigurimin e shërbimeve për përgatitjen e pyetësorit per aksesin ne financa te SME-ve dhe shpërndarjen e tij tek bizneset SME të qarkut Fier, me qëllim realizimin e objektivave të Projektit.

TERMA REFERENCE

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E KONTRAKTIMIT

Synimi i përgjithshëm i kontraktimit është sigurimi i shërbimeve për përgatitjen e nje pyetesori per aksesin ne financa dhe rruget e financimit te SME-ve, me qellim permiresimin e ketij aksesi, në kuadër të projektit “**3C4SME Work Plan of the Context Analysis**”, për realizimin e nje studimi me bizneset e vogla dhe të mesme, kryesisht bujqesore dhe tregtare, për vlerësimin e nevojave te tyre per kredi në Bashkine Fier.



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

2. Sherbimet kontraktuale

QSHPZH kerkon te realizoje dy sherbime kontraktuale:

2.1. Nje Pyetesor, i cili duhet te kerkoje nga SME-te:

1. Te dhena per aksesin e tyre te deritanishem ne financa
2. Opinion mbi instrumentet e kreditimit (kredia bankare, leasing, etj.)
3. Opinion mbi bashkepunimin me partnere nga Italia, Mali i Zi, etj.
4. Opinion mbi domosdoshmerine e permiresimeve ligjore te aksesit te SME-v ne financa
5. Opinion mbi perfshirjen e Shtetit dhe fondeve publike për të mbështetur permiresimin e qasjes ne kredi dhe financa te SME-ve.

2.2. Shperndarjen e Pyetesorit ne nje kampion perfaqesues te SME-ve ne qarkun e Fierit, i cili te respektoje:

- A. Peshen specifike te sektoreve te ndryshem te ekonomise ku veprojne SME-te
- B. Shperndarjen e SME-ve sipas numrit te punonjesve.

QSHPZH kerkon:

- Kompani/OJF të interesuara per sigurimin e shërbimeve si me siper shpjeguar.

Fondi limit është **861,000** lekë

3. Data dhe vendi

Me kërkesë të organizatës, produktet dhe shërbimet do të dorëzohen në Qendren *Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin*, adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta, Nd.26, H.6, Ap5, 1001,Tiranë, Albania.

4. Profili i kërkuar i kompanisë/OJF aplikuese

- Kontakte, njohuri dhe informacion te gjere rreth bizneseve te vogla dhe te mesme(SME) ne shkalle vendi dhe per qarkun Fier ne veçanti
- Njohuri te gjera per sistemin financat e biznesit dhe sistemin bankar, ne veçanti per bankat tregtare dhe politiken e tyre te kreditimit
- Experience e vërtetuar pune në fushën e raporteve dhe vrojttimeve njohese te strukturave te biznesit ne shkalle vendi dhe per qarkun Fier ne veçanti
- Njohuri shumë të mira rreth situatës dhe problematikës së biznesit, shoqatave te biznesit dhe kuadrit ligjor per bizneset ne Shqiperi .
- Eksperiençë profesionale pune me organizatat e shoqërisë civile apo institucione te tjera per realizimin e Sherbimeve te ngjashme.

5. Kontratat dhe Tarifat

Kompania/OJF do të lidhë një kontratë shërbimi me organizatën. Pagesa do të kryhet në llogarinë bankare të kompanisë/OJF sipas kushteve të rena dakort në kontratë dhe dorëzimit të produkteve dhe shërbimeve përkatëse.

Produktet dhe shërbimet orientuese janë:

1. Realizimi i një Pyetësi për aksesin në financa të SME-ve të qarkut Fier
2. Shpërndarja e Pyetësit në një kampionim përfaqësues të SME-ve të qarkut Fier, me një numër 150-200 SME-sh përfaqësues të kampionuara. Dokumenti vertetues i efektivitetit të shpërndarjes- lista me përgjigjet e SME-ve ndaj pyetësit
3. Konsultimi paraprak me organet tatimore të qarkut, me shoqatat e biznesit dhe me eksperte të fushave të ndryshme të aktivitetit të SME-ve që do të perzgjidhen në liste.

Aplikimi

Ju ftojmë të shprehni interesin tuaj duke dërguar aplikimet tuaja brenda datës **03.03.2020, ora 16:30** me E-mail (info@acpd.org.al) me postë ose dorazi në adresën (adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta, Nd.26, H.6, Ap5, 1001,Tiranë, Albania, tel:

Çdo aplikim i marrë pas datës së mbylljes së procedurës nuk do të pranohet.

Dokumentat e aplikantit si më poshtë:

- NIPT , Statut , Vendim gjykate / apo Ekstrakt QKB , Cv,
- Oferta Financiare në Vlerë Bruto (përfshirë Taksat) për shërbimin që kërkohet.

Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për plotësimin e dokumentacionit , eskperiences dhe oferten me të ulet financiare.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH), inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.